

INTERVISTË ME DREJTORIN E FSPIM SHAIP ZENELI


BASHKËPUNIMI NË NIVEL TË DËSHIRUESHËM, POR DO TA PASUROJMË ME PËRMBAJTJE DHE FORMA TË REJA

Revista javor "Pensioner Plus" ka realizuar një intervistë me drejtorin e FSPIM, Shaip Zeneli ku është vërtetuar bashkëpunimi i ngushtë mes dy institucioneve, FSPIM dhe LSHPM.

Z.Zeneli, na tregoni si ka rrjedhë ky bashkëpunim gjatë viteve që kur jeni drejtor i Fondit përsigurim pensional dhe invalidor?

Me emërimin tim, në muajin dhjetor të vitit 2015, kam përmirësuar bashkëpunimin e deritanishëm mes Fondit dhe LSHPM. Gjatë kësaj periudhe kemi mbajtur shumë takime ku kemi biseduar në drejtim të mbrojtjes dhe avancimit të synimeve dhe interesave të përbashkëta të shfrytëzuesve të pensionit në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Të gjitha ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për SPI që janë bërë në vijim, si dhe dispozitat tjera që kanë patur ndikim në sistemin e sigurimit pensional dhe invalidor, Fondi i realizon me sukses



dhe disponon me kapacitete institucionale për realizimin e të drejtave të pensionistëve të ardhshëm. Bashkëpunimi është në nivel të dëshirueshëm, ndërsa ne dhe Lidhja e shoqatave të pensionistëve të Maqedonisë, mundohemi që të jetë edhe më e mirë dhe e pasuruar me forma dhe përmbajtje të reja.

Për momentin, cilat projekte janë lëndë e bashkëpunimit mes Fondit të FSPIM dhe LSHPM?

Fondi i SPIMV dhe LSHPM në pajtim me Protokollin për bashkëpunim rregullisht këmbejnë të

dhëna për përdoruesit e pensionit. Kryesisht, në formë elektronike në nivel mëdhor dorëzohen të dhëna për statusin e pensionistëve, anëtarësinë në Shoqatat e pensionistëve, anëtarët e LSHPM dhe këmbëhen të dhëna për numrin e të vdekurve dhe shfrytëzuesve të rinj të pensionit. Saktësimi i të dhëna ve përeveshtë një prej preku-pimeve më të rëndësishme të bashkëpunimit të ndërsjellë.

Pensionistët janë veçanërisht të kënaqur që gjatë vitit të fundit Fondi ka marrë për obligim realizimin e tërësisë hënë të rekreacionit falas në banja. Sa pensionistë kanë shfrytëzuar këtë mundësi?

Të gjitha aktivitetet tona janë në drejtim të lehtësimit dhe përmirësimit sa më të mirë të jetës së qytetarëve tanë, e posaçërisht atyre më të moshuarve. Në atë drejtim është edhe marrja e këtij obligimi nga ana jonë. Me vendim të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut në vitin 2019, FSPIMV mori të gjitha aktivitetet e nevojshme për realizimin e këtij projekti. Kryesisht, vetëm në vitin 2019 këtë të drejtë e kanë shfrytëzuar 2355 pensionistë.

Pensionistët, gjegjësisht Lidhja është e interesuar përgesën e rregullit të pensioneve. Si është gjendja me mjetet e nevojshme për atë qëllim? Vallë, a ka ndonjë problem?

Në pajtim me dispozitat ligjore, Fondi bën rregullisht pagesën e pensioneve në javën e parë të muajit përmuanin paraprak. Mjetet për pagesë të pensioneve janë në nivel solid dhe FSPIMV nuk ka problem financiar përgesë të pensioneve. Kjo do të thotë se pensionet nuk duhet të shqetësohen përsigurinë e tyre materiale dhe sociale.

Udhëheqësia e LSHPM është posaçërisht e kënaqur me gatishmërinë e Fondit që të ndihmojë në rregullimin dhe harmonizimin e të dhënavë që i përdorë Këshilli i organizimit të regjistruar përanëtarësim dhe ndihmë pas vdekjes, me çka sigurohen mjete në kohë përkaktive të 53 shoqatave tona anëtare të Lidhjes. Na tregoni se çka ka ndërmarrë FSPIM në këtë drejtim?

FSPIM ka mbajtur takim me përfaqësuesit e LSHPM ku janë marrë vesh që shoqatat të sigurojnë të dhëna përanëtarësinë në shoqata, sipas shifrës së shoqatave. Shifrat e njëjtë Fondi i ka marrë në kohë dhe i ka azhurnuar në bazën e vet të të dhënavë. Me atë është fituar e dhënë e saktë e pensionistëve nëpër shoqata.

Kalina S. Andonova

SHPÇAIR

I PALODHSHMI XHEMAIL SHKRETA

Xhemail Shkreta, në shikim të parë është vetëm një njeri i thjeshtë, të cilin nuk mund ta dalloni nga të tjerët, për ta zbuluar tregimin e tij të jetës. Por, pasi që ta hap shpirtin, do të bindeni që rruga e jetës së tij është shumë më e ndryshme se e tjerëve. Krahas sinqueritit, ai jetën e tij e ka kthyer edhe në drejtim të humanizmit, ndihmës së njerëzve dhe aktivitetave pensioniste. I thjeshtë, i qetë, por i sigurt në gjithçka. Si të tillë e njohin edhe tani, i cili më shumë se 8 vite i ndjen përfitimet e jetës pensioniste. Xhemaili është një nga pensionistët e rrallë të SHP Çair, i cili e përmbylli qëllimin e tij të ditës dhe që do të mirembahet rendit që e ka në vete, që para pensionimit në vitin 2012. Pjesën më të madhe e kalon në Klubit e pensio-

nistëve të SHP Çair, të vendosur në shtëpinë e pensionistëve në Fushë Topanë. Kur ta njoftoni, atëherë do ta keni të qartë prej nga vjen ajo energji dhe aftësi e madhe e punës tek ai, që të mund të ballafaqohet me të gjitha pengesat dhe vështirësitë. Vet, pensionimin e ka kupuar si një fillim të ri në jetë.

"Kur kalova në pensionim, habitesha se çfarë do të bëj dhe me çka do ta mbys monotonë. Zgjedhjen e gjeta në angazhimin në SHP Çair. Për arsy që arrija me aktivitetet e mia, shumë shpejt u vendosa për nikqir të Klubit, ku edhe sot e kësaj dite punoj", është shprehur Xhemail Shkreta.

Takimi me Xhemon, nuk të ka, ndërsa të mos e vëresh që në klub gjithçka është në rregull. Në të gjitha tavolinat janë të radhitu-

ra rekuizitat për lojë dhe argëtim të pensionistëve, të cilët çdo ditë janë këtu. Në dispozicion të pranishmëve janë vendosur më shumë shkoja të revistës së pensionistëve "Penzioner plus", "Penzionerski vidi" dhe "Koha", në të cilat ai është lexuesi më i rregullt. Përndryshe, humanizmi dhe ndershmëria janë tiparet e tij kryesore. Xhemo Shkreta është shembull para se gjithash për një njeri human, i cili edhe deri më sot palodhshëm dëshmohet përmes veprave të tij humane dhe jeton çdo ditë me atë ndjenjë të mirë. Ai çdo ditëju ndihmon personave të moshuar në shtëpinë e pensionistëve.

"Të moshuar janë dhe më thérasin që t'ju ndihmoj ose t'ju kryejë ndonjë punë. E gjithë ajo më bën të lumtur dhe shpirtërisht më të pasur. Krahas asaj, e mirëmbaj edhe parkun përpëra shtëpisë", tregon Xhemaja dhe rikujtohet në më shumë ndodhi. Xhemaja është aktiv edhe në më shumë disciplina të sportit në LP Çair, por më së shumti e mahnitë tertiqja e litarit. Vasil Paçemski.

